

## EDITORIAL

*Në fund të fundit integrimin evropian shumica e shqiptarëve e kuptojnë si lëvizje e lirë, pra si emigracion, dmth si mundësi për t'u punësuar jashtë shtetit*

# Demokraci e lodhur



Kabineti Berisha 1

## Letërsi

### "Harro se ç`kemi biseduar"



Promovim Libri

Lexoni në faqen 12

## Reportazh

### Me dr. Jani Bashon e prof. Sazan Çelikun në Shën Marenën e Mokrës!



Lexoni në faqet 8-9-10

## Arsimi

### Shkolla jopublike "Nehemia" drejt finalizimit të identitetit



Lexoni në faqen 4

## Kulturë

### Majestik –një legjendë e kulturës korçare



*Kjo ndërtesë ka tetëdhjetë e ca vjet që ka ngulur themelet e veta në truallin korçar dhe bën dritë dhe hije buzë bulevardit "Republika"*

Lexoni në faqen 6

## Biznes

### Vetëm ne kemi detyrime ndaj shtetit?

*Na u duk shumë interesante pyetja e një prej pjesëmarrësve të biznesit të vogël në takimin e organizuar në qytetin e Pogradecit në ambientet e Hotel "Enkelanës" më datën 10.09.2009. Kjo na motivoi për ta vendosur atë si titull të shkrimit tonë, pasi në vete ajo përmbledh gjithë shqetësimet dhe raportet e ndërsjellta shtet-biznes...*

Lexoni në faqen 5



# BANKA POPULLORE

SOCIETE GENERALE GROUP

# Socialistët korçarë me Ramën

Veteranët dhe ushtarakët siç duket janë më të vendosurit; Rama të mbetet kryetar. Në biseda të zjarra që bëhen nëpër lokale apo nëpër lulishte, ku të të moshuarit kalojnë kohën e lirë Rama fiton më shumë pikë.

Po nuk mungojnë përkrahësit e Nanos. Ata presin që ish kryetari të dalë përsëri në ballë të partisë. Partisë sonë i duhet Nanua, shprehen përkrahësit e tij. Por gjen edhe socialistë që nuk duan të

## -Partisë i duhet përsëri Nano

identifikohen duke u shprehur se "Rama ra nga thana." Shembulli i Nanos duhet të bëhet traditë në partinë tonë. Nuk realizove objektivin, lëre drejtimin, hapi rrugë një të riu. Debatet ndizen dhe tensionohen. Ditët e kongresit po afrojnë.

Për socialistët e Maliqit mbështetja është për Ramën. Bashkim Hazisllari, kryetar i Partisë

Socialiste për Bashkinë e Maliqit shprehet hapur në qëndrimin e tij dhe të socialistëve që ai përfaqëson. "Padyshim, që në mbështesim Ramën, nuk ka kryetar tjetër përveç atij."

Qëndrim të hapur shprehin dhe ushtarakët socialistë. Kiço Tele, kreu i ushtarakëve të liruar dhe në rezervë është i vendosur se në votimin një anëtar një votë vota e

tyre është për kandidaturën e Ramës. Ben Blushi, sipas ushtarakëve nuk ka ndonjë mbështetje të madhe. Ai mund të marrë jo më shumë se 17 vota nga socialistët korçarë.

Për ushtarakët Rama mbetet si shpresa e tyre në realizimin e premtimeve që ai u ka dhënë për të fituar statusin.

Ndërsa drejtuesit e tjerë të Partisë Socialiste në Qarkun e Korçës nuk shprehin hapur qëndrimin e tyre, por përgjigja e tyre është e shkurtër se jemi me partinë socialiste pa dhënë hollësi se a duhet të jetë Rama në krye apo ndonjë figurë tjetër.

# Qepët po shiten jashtë

## Ka nisur eksporti me tre shtete

Qepët e Korçës po përdoren këtë vit në kuzhinat e huaja. Në tre shtete janë shkarkuar maunet me prodhim të mbarë të fermerëve korçarë. Peshën më të madhe për prodhimin e qepës e zë rrethi i Devollit. Për to është gjetur treg në tri shtete. Një vit më parë nga mbetja pa shitur fermerët humbën 1 milion euro. Largimi i qepëve për tregun e jashtëm ka zgjuar interes tek fermerët, por rrezikon tregun e brendshëm duke e rritur çmimin e tyre. Eksporti sa ka nisur. Nëse nxirren sasira të mëdha në tregun e jashtëm edhe qepën do ta kërkojmë me qiri. Gjithsesi ky është një sinjal i mirë për fermerët e Devollit, të cilët e punojnë dhe mbjellin çdo pëllëmbë tokë.

Një vit më parë tonelata me qepë u flakën në lumin e Devollit. Nuk u gjend treg për të shitur këtë prodhim të fushave të Devollit. Zona e Mirasit, më e njohura për qepën, humbi vitin e kaluar miliona

lekë. Po për këtë vit për fermerët ka nisur shitja e qepëve jashtë vendit. Deri tani kanë dalë 200 ton qepë, e cila ka shkuar në Maqedoni, Kosovë dhe Kroaci.

Drejtori i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për qarkun e Korçës Adrian Maho u shpreh: "Përveç qepës, që ka nisur eksporti në tre shtete, po synojmë që të nxjerrim jashtë edhe mollën me patatet. Tregu është i garantuar për qepën e fermerëve dhe ajo nuk do të flakët më në lumë. Kjo siguron punimin e gjithë sipërfaqes së tokës dhe duke patur një treg të mirë dhe të garantuar fermerët do të stimulohen për të rritur prodhimin si dhe cilësinë e tij."

Rreziku për ngritje çmimi ekziston nëse nuk kontrollon sasia që do të nxirret për jashtë shtetit. Por eksporti ha qepët cilësore. Në tregun e brendshëm shiten ato me cilësi të dobët, por çmimi në treg mbahet i lartë.

# Ujërat e zeza të burgut "plehojnë" Zapet

Burgu i sigurisë së lartë, i ngritur në territorin e komunës së Drenovës nga brenda është i parametrave europiane. Por ujrat e zeza që prodhohen në këtë burg janë bërë shqetësuese për banorët e dy fshatrave të komunës së Drenovës, për fshatin Zape dhe Qatrom.

E vështirë është bërë vajtja në fshatin Zape, pasi ujrat e zeza që dalin nga burgu do të shoqërojnë një copë rrugë të mirë. Era e rëndë për kalimtarët e shumtë që rrahin rrugën për në fshatin turistik të Dardhës, prish imazhin e mirë që ata marrin nga pikniket apo vizitat. Për kalimtarët që janë kalimtarë ndjehet era e rëndë, por për banorët mbetet akoma më shqetësuese.

Fiqiri Rusi, njëri prej banorëve më të vjetër të fshatit Zape, që ka ardhur i pari të banojë në këtë fshat na tregon se hallet nuk kanë të sosur. Fshati Zape është ngritur në vitin 1960. Ai nuk ekziston as në hartën e Shqipërisë. Fshati arriti të zgjerohet deri në 45 shtëpi dhe u ngrit për Stacionin e Bagëtive të Imta. Gjysma e shtëpive të tij janë të mbyllura. Të rinjtë kanë ikur në Greqi. Kanë mbetur të moshuarit dhe pak fëmijë të vegjël. Ky fshat nuk ka as shkollë. Po le të mbetemi tek fenomeni i ujrave të zeza.

"Nuk na dalin ujrat tona të zeza, po na edhe ato të burgut" -thotë i moshuari që kullot dy lopët e tija. "Ujrat tona të zeza nuk kanë kanalizime dhe mblidhen në gropa. Në ditët e verës nga fermentimi që ndodh të mbytet era e keqe e tyre."

Burgu i ri që u ngrit një vit më parë me financim dhe parametrat e BE-së ka sjell telashe për banorët e fshatit Zape. Ujërat e zeza që dalin nga burgu kalojnë pranë fshatit. Para pak kohësh ato ishin lënë të lira në derdhje dhe me ankesat e banorëve u futën në kanal kryesor, por të zbuluara dhe prej andej derdhen në shtratin e një përroi, i cili vazhdon rrugën drejt rrugës nacionale që lidh Korçën me Ersekën dhe mësyn në fshatin Qatrom. Në të njëjtën kohë rruga që të shpie për në Zape vazhdon për në fshatrat Boboshticë dhe Dardhë. Sa ndahesh nga rruga nacionale e merr kthesën për në Zape në krah të majtë do të shohësh dhe kanal in e mbushur me ujërat e zeza. Janë 400 metra rrugë që në krahun e sipërm të tyre u bëjnë shoqëri ujrat e zeza që dalin nga burgu. Një rrezik tjetër përbëjnë edhe për përhapjen e sëmundjeve nga ana e qenve të cilët pinë ujë në këtë kanal. "Jo vetëm për shëndetin tonë, por edhe të blegtorisë bën dëm ky kanal i mbushur me mbeturinat e burgut", na thotë Zylal Çorbaxhi, i cili ka një tufë me dele.

Shqetësuese ujrat e zeza apo të përdorura të burgut të ri, që është ngritur në komunën e Drenovës, janë edhe për banorët e fshatit me 400 shtëpi Qatrom, pasi përroi ku ato derdhen kalon mes përmes fshatit. Burgu i sigurisë së lartë është i parametrave europiane brenda, por mbetet me parametra shqiptare jashtë.

P.Çuni

# Nis punimet e gjykata e re e faktit

Gjykata e faktit në Korçë do të zhvendoset në një godinë të re. Ndërtimi financohet nga buxheti i shtetit. Janë vënë në dispozicion 140 milion lekë të reja. Puna për ngritjen e saj ka nisur këto ditë dhe synohet që punimet të avancojnë dhe të dorëzohet dy muaj para afatit. Ajo po ndërtohet në afërsi të gjykatës së Apelit, çka lehtëson dhe punën e qytetarëve për t'i patur të dyja shkallët e gjykatave pranë.

Sipas kryetarit të Gjykatës të Faktit

Korçë Admir Belishtës, godina do të jetë katërkateshe dhe do të plotësojë të gjitha parametrat bashkëkohore të një gjykate. Ajo do të ketë pesë salla të mëdha gjykimi nga dy që ka godina e sotme, në të cilën është vendosur, kushte dhe mjedise të favorshme për ekipin e gjyqtarëve, si dhe lehtësira për komunitetin. Godina ekzistuese do t'i kthehet Bashkisë së Korçës, pasi janë ambientet e saj. Në të njëjtën godinë do të jetë dhe prokuroria.

## EDITORIAL

Duket sikur në lëmin e politikës sonë ka ndryshime dhe zhvillime, por në fakt, ka vetëm një riciklim. Riciklohen qeveria e parlamenti, lëvizjet politike majtas-djathtas, akuza për vjedhje votash e bojkot, prioritete në programe dhe përbaltje ndaj njëri-tjetrit. Me pak fjalë gjithçka përmbledhet: “asgjë të re nga fronti i politikës”. Demokracia jonë pothuajse 20-vjeçare është lodhur ende pa përfunduar tranzicioni dhe nuk arrin të prodhojë ide të reja, me gjithë tualetin e sforcuar me fytyra të reja. Kjo vihet re edhe në faktin se “fytyrat e reja” të politikës s’janë as më pak e as më shumë se kopje të liderëve historikë.

Deri këtu nuk ka asgjë të re.

Të nisura pa programe konkrete në garën elektorale, dy partitë kryesore u mbajtën pas sloganeve të gjithëpranuara për integrimin evropian të Shqipërisë. Një slogan i hershëm, i shfaqur në vitin 1990 në formën “ta bëjmë Shqipërinë si gjithë Evropa”. Por i vetmi premtim konkret dhe i kapshëm që u realizua nga qeverisja e djathtë ishte dyfishimi i pagave të administratës, gjë që sigurisht ndikoi në rezultatin e zgjedhjeve. Në fund të fundit integrimin evropian shumica e shqiptarëve e kuptojnë si lëvizje e lirë, pra si emigracion, dmth si mundësi për t’u punësuar jashtë shtetit. Të pakët janë ata që e kanë luksin ta kuptojnë si mundësi për barazi me shtetasit evropianë, si dinjitet, si mundësi për t’u mjekuar në klinika të specializuara, për t’u shkolluar, si hapësirë për udhëtime turistike, etj

Asgjë të re s’ka deri këtu.

Pra bëhet fjalë më shumë për mbijetesë. Nëse do të kishte programe konkrete punësimi, sigurisht që integrimi do të merrte tjetër kuptim. Por kur flitet për punësim, liderët tanë duket sikur marrin pjesë në një garë gënjeshtresh; unë do të hap 120 mijë vende pune, jo, unë do të hap 180 mijë... Por askush s’thotë si, ku, kur. Kjo bën që edhe pas 20 vitesh tranzicion shumica e njerëzve t’i kenë sytë nga emigracioni, sepse ata që janë të papunë s’gjejnë dot hapësirë punësimi; ata që janë në punë, janë të rrezikuar nga çdo rotacion i mundshëm i pushtetit. Të gjitha këto përbëjnë kufizimin e lirisë.

Dhe kjo s’është gjë e re.

Edhe atë pak liri qytetare që shprehet në një ditë të vetme, një herë në disa vjet, pra votimin, politikanët e kanë dhunuar dhe tjetërsuar. Të gjithë akuzojnë për vjedhje votash dhe të gjithë akuzohen. Vetëm disa ditë më parë lideri Berisha deklaroi se ia vodhën “një mandat në Fier”. Lideri i PS-së sigurisht që pretendon për vjedhje mandatesh, duke e quajtur votimin maskaradë. Por pretendime dhe akuza kishte Meta, Mediu, Muhedini, Ndoka, etj. Po t’i besosh akuzat e tyre, del se të gjithë kanë punuar për të devijuar votën qytetare.

Dhe kjo është diçka e njohur.



Kabineti Berisha 1

*Në fund të fundit integrimin evropian shumica e shqiptarëve e kuptojnë si lëvizje e lirë, pra si emigracion, dmth si mundësi për t’u punësuar jashtë shtetit*

## Demokraci e lodhur

Ende pa përfunduar procesi zgjedhor, shumë parti, sidomos partitë e vogla dhe ato humbëse ia hodhën fajin për disfatën e tyre sistemit të papërshtatshëm elektorale. Deri tani janë përdorur të gjitha sistemet, mazhoritar i korigjuar me proporcional, proporcional rajonal, sistemi spanjoll, gjerman... të gjithë rezultuan të papërshtatshëm për kushtet tona. Kjo sepse që në konceptimin e sistemit, të gjithë përpiqen të gjejnë hapësia për të abuzuar me votat. Pa dalë mirë rezultatet, të gjithë, fitues dhe humbës deklaruan dhe premtuan se e para gjë që do të bëjnë, është reforma zgjedhore, dmth kthimi tek sistemi proporcional kombëtar. Do të vazhdojë reforma, ndonëse u deklarua se ajo tashmë ishte kryer. Thua se fajin e ka sistemi dhe jo ata që e zbatojnë. Një gjë është e sigurt, që pas zgjedhjeve të ardhshme, do të kërkohet që të ndryshojë sistemi zgjedhor dhe të vazhdojë reforma zgjedhore.

Por edhe kjo s’është ndonjë gjë e re dhe e padëgjuar.

Ne riciklojmë mënyrën e vlerësimit të votimit duke u krahasuar me vetveten dhe jo me të tjerët rretheqark. Fituesit gjithmonë deklarojnë se zgjedhjet ishin më të mirat që kemi zhvilluar deri sot. Të njëjtën gjë vazhdojmë ta dëgjojmë. Flasin me veten para pasqyrës.

Kjo është gjë tashmë e stërdëgjuar.

Për gjithë arsyet e mësipërme, ne vazhdojmë të kemi qeveri të fortë dhe qytetarë të dobët në aspektin e demokracisë. Kemi qytetarë që shteti përpriqet me të gjitha mënyrat dhe strukturat t’i

mbajë të gjuhëzuar, duke u bërë presion me vendin e punës, me shkollën e fëmijëve, me rrogën e bashkëshortëve... Vite më parë një patriot i njohur dhe luftëtar i dy luftimeve botërore thoshte për qeverinë e Enver Hoxhës: Kjo është qeveri e fortë, se të ngrys gjeneral dhe të gdhin tatar! Në fakt e thosh disa në mënyrë të zbutur, se mund të të ngryste gjeneral dhe të të gdhinte në burg, ashtu sikurse ka ndodhur shpesh.

Demokracia jonë e lodhur s’ka gjetur dot formë tjetër përveçse ta mbajë individin të varur pas shtetit me njëqind hallka nga interesi financiar, e drejta për t’u strehuar, punësuar, shkolluar, për të bërë karrierë në administratë etj. Me rastin më të parë të rotacionit politik, mund “të ngrysesh gjeneral dhe të gdhiesh tatar”. Këtë e kanë bërë të gjitha partitë pa përjashtim, sa herë që kanë qenë në pushtet. Edhe kur parti të vogla kanë marrë në dorë ndonjë dikaster, kanë përdorur “fshesën e madhe”. Nuk mund të jetë i lirë një njeri që e ka fatin e tij dhe të familjes të varur tek partia. Bie fjala, si mund të bësh karrierë në sistemin shëndetësor, kur ky sistem është marrë në dorë edhe nga PD, edhe nga PS, PDK, PR e me radhë...

Në programet e partive s’ka asnjëherë objektiva lidhur me lirinë e individit, me karrierën, me rolin e qytetarit përballë shtetit dhe institucioneve, sepse ato më shumë merren me vetveten dhe njëra-tjetrën.

Demokracia jonë tashmë është lodhur dhe po konsumon vetveten.

*një aktivitet i gjerë, kushtuar vlerave dhe synimeve që ka arrirë*

# Shkolla jopublike "Nehemia" drejt finalizimit të identitetit

Në vigjilje të çeljes zyrtare të vitit të ri mësimor dhe akademik 2009-2010 në ambientet komode dhe bashkëkohore të Fondacionit "Nehemia" me qendër në Buçimas Pogradec më datën 09.09.2009 u organizua një aktivitet i gjerë, kushtuar vlerave dhe synimeve që ka arrirë dhe synon të arrijë shkolla jopublike e këtij fondacioni në një të ardhme jo të largët.

Aktiviteti ishte me temë: "Edukimi "Nehemia" nga kopështi në universitet". Kjo shërbeu si një ditë e veçantë e paraqitjes së konceptit, që ka ky fondacion dhe misionarët e tij për arsimin, duke ofruar edukim e arsimim nga kopshti në universitet me të veçantat e tij. Kjo ishte dhe ideja e gjithë këtij aktiviteti e konkretizuar në të gjithë ligjëruesit e referateve, sipas fushave dhe sektorëve përkatës.

Rëndësinë e këtij aktiviteti e tregoi pjesëmarrja dhe përshëndetja e Atasheut Kulturor në Ambasadën e Republikës Gjermane në Tiranë, zonjës Irene Eidemuller, Presidentit të fondacionit, zotit Arnold Gaiger, profesorë e akademikë nga vendi, drejtori i Zyrës Arsimore të rrethit zoti Guri Isufi, kryetarët e komunës Buçimas dhe Dardhas, Roshi Tollozhina dhe Rushan Çela, stafi didaktiko-pedagogjik i kësaj shkolle me zotin Drini Hajdini, prindër, miq, të ftuar.

Në pjesën e parë që vlerësohej si pjesa akademike pas përshëndetjes me të ftuarit, u mbajtën ligjëratat: Prof.Asoc. Dr. Marjana Sinani "Fëmijët "Nehemia"-vendi i tyre aktual dhe i ardhshëm në shoqërinë shqiptare", e cila në mënyrë shumë analitike dhe të



kujdesshme kishte vëzhguar rregulloren e kësaj shkolle të hartuar mbi bazën e parimeve Biblike 6 parimet Universale të Kristianizmit: Përkushtim, Ndershmëri, Respekt, Falje, Integritet, Dhembshuri dhe gjithë aktivitetin e ngritur mbi të. Ajo e vlerësoi si një "Kushtetutë" moderne e një shkolle moderne. Vlerësoi lart Platformën Morale të edukimit në raport me atë Civile, konceptin "Fëmijët "Nehemia" dhe "Nxënësit "Nehemia", "njeriu" apo "individ", të gjitha këto në procesin e edukimit dhe të mësimit raportet e tyre.

Shkolla "Nehemia" i realizon këto

në unitet dhe kjo është idealja, në kushtet, kur shkolla shqiptare e ndjen krizën në kushtet e një "shoqërie të hapur". Komuniteti i kësaj shkolle shkon drejt finalizimit të identitetit, gjë që realizohet me hapjen e Universitetit "Nehemia" në këtë vit akademik me staf pedagogjik e shkencor me grada shkencore nga Gjermania, Holanda e vende të tjera.

Kurset akademike do të fillojnë në tetor 2009 dhe do jenë:

- Bachelor "Biznes e ekonomi"
- Fakulteti i shkencave humane, master (diploma e nivelit të dytë)

-Dhe studime europiane në bashkëpunim me Libertas European Institute.

Interesant ishte transmetimi Online i përshëndetjes së Prof. Dr. Kurt Schonerr në internet me zotin Arnold për temën: "Arsimi nga kopështi në universitet-domosdoshmëri apo marrëzi?".

Prof. Aleksander von Freyhold referoi: "Universiteti "Nehemia" në panelin e arsimit shqiptar -tendencë mode apo plotësim i nevojave të shoqërisë shqiptare".

Lidhur me partneritetin referoi Gertie Gijsbertsen-Blaawendraad nga Universiteti CHE i Krishter për Shkencat e Aplikuara Hollandë.

Nuk mungoi dhe prezantimi i godinës së re arsimore dhe i shtëpisë së miqve si pjesë përbërëse i një arsimit të suksesshëm nga Helmut Hauser.

Barbara von Schnurbein prezantoi nismat për mbështetjen e arsimit "Nehemia". Ute Hauser prezantoi nismën në kuadër të programit 1000 për arsimin. Pjesa e dytë e këtij aktiviteti ishte parashikuar të zhvillohej me çeljen e vitit të ri shkollor, partneriteti me shkollat e tjera, prezantim nga Helmut Hauser dhe aktivitete të tjera dhe pjesa e tretë do të mbyllej me aktivitete të fëmijëve me karakter sportiv, kulturor dhe trajnime.

**Dh.Gegprifti**

## Shkollat të tejngopura, 9-vjeçarja me dy turne

Për disa shkolla 9-vjeçare në Korçë nuk do të hiqet turni i dytë, për gjimnazet nuk ka vende për të thithur të gjithë nxënësit që kanë bërë kërkesë për të nisur klasën e 10-të pranë tyre.

Shkolla "Mësonjtorja" është gati për të pritur nxënësit, por me të vetmin problem se nxënësit do

të vazhdojnë mësim me dy turne. Bërja e mësimit me dy turne në qytetin e Korçës është tepër i vështirë në periudhën e dimrit. Po të njëjtin fat kanë edhe nxënësit e shkollës 9-vjeçare "Asdreni". Përsa u përket tre gjimnazeve që ka qyteti thithja e të gjithë nxënësve që do të nisin klasën e

10-të, nuk ka mundësi të realizohet sepse nga 800 kërkesa, mundësitë e pranimit janë vetëm për 520. Vetëm në gjimnazin "Themistokli Gërmenji" janë depozituar 334 kërkesa. Sipas drejtorit të shkollës mundësitë për të filluar për herë të parë në këtë gjimnaz janë vetëm për 220 nxënës. Nga kërkesat që janë bërë do të përzgjidhen nxënësit më të mirë për të vazhduar mësim në këtë gjimnaz. Po kështu dhe në gjimnazin "Raqi Qirinxhi" nuk pranohen nxënës nga fshati që kanë dëshirë të ndjekin këtë

gjimnaz me emër të mirë. Në këtë gjimnaz do të nisin mësim në klasën e10-të 180 nxënës. Problem në këtë gjimnaz mbetet tarraca e godinës, e cila ka nevojë për izolim.

Qyteti i Korçës ka 10 shkolla të mesme, nga ku 3 janë gjimnaze dhe të tjerat shkolla profesionale. Po dhe shkolla të arsimit 9-vjeçar janë10. Nevoja për zgjerim e godinave të arsimit 9-vjeçar është emergjente, por edhe për këtë vit fëmijët e vegjël do të mësojnë me dy turne.

**P.Çuni**

## BIZNES

# Vetëm ne kemi detyrime ndaj shtetit?

Na u duk shumë interesante pyetja e një prej pjesëmarrësve të biznesit të vogël në takimin e organizuar në qytetin e Pogradecit në ambientet e Hotel "Enkelanës" më datën 10.09.2009. Kjo na motivoi për ta vendosur atë si titull të shkrimit tonë, pasi në vete ajo përmbledh gjithë shqetësimet dhe raportet e ndërsjella shtet-biznes.

Takimi u organizua nga Agjensia Rajonale e Zhvillimit (SME) në Korçë me drejtor zotin Aurel Grabocka në bashkëpunim me Programin e Qeverisjes Vendore të USAID me përfaqësuese zonjën Silvana Meko, përfaqësues nga institucione të qytetit të Korçës, zoti Vladimir Cepa, kryetar dhe avokat në Dhomën e Tregëtisë Korçë-Greqi, punonjës të këtij sektori nga Bashkia Pogradec si dhe në partneritet me shoqatën e Biznesit të Vogël të këtij qyteti me kryetar zotin Flamur Daci. Merrnin pjesë të ftuar nga mediat lokale.

Qëllimi i këtij aktiviteti sipas organizatorëve ishte sensibilizimi i sipërmarrësve të Biznesit të Vogël në lidhje me Legjislacionin për taksat dhe

## Po shteti nuk ka ndaj nesh?!...



tarifat vendore. Organizatorët ishin të mendimit se duhet të jemi të njohur me të drejtat dhe detyrat në fushën e biznesit në mënyrë që të respektohet ligji, por edhe të kërkojnë llogari pranë institucioneve vendore dhe qendrore për zbatimin me përpikmëri dhe barazi

të të gjitha ligjeve, që kanë lidhje me taksat dhe tarifat vendore. Në këtë takim kishte përfaqësues nga biznese dhe shoqata të ndryshme të qyteti, nga shoqata "Unë Gruaja" e të tjera.

Pas prezantimit dhe njohjes me Legjislacionin në fuqi në Republikën

e Shqipërisë nga zonja Meko, u kalua në pyetje dhe diskutime, të cilat pothuajse vërtiteshin rreth problemeve dhe shqetësimeve të njëjta: raporte jo të drejta institucione-biznes, biznese të palicensuara -rreth 200, konkurrencë e pandershme, 35-40 % nuk paguajnë taksat, u diskutua për taksën e gjelbërimit, për subjektet ambulante, aktiviteti i tyre duhet parë. Në takime të tilla mungojnë titullarë të bashkisë apo të Këshillit Bashkiak; u diskutua vendosja e ditës së pushimit dhe koordinimi i saj; ka biznese që hapen e mbyllen, ka biznese që paguajnë taksat dhe nuk paguajnë tatimet e të tjera; si do veprohet me kasat regjistruese të blera dhe ato që do blihen; konkurrenca e pandershme në transportin e udhëtarëve ndërqytetës dhe fshat qytet.

Në përfundim pjesëmarrësit kërkuan më shumë bashkëpunim, mbështetje nga pushteti vendor me të gjitha strukturat e tjera. Organizatorët premtuan se do të vazhdojnë t'i mbështesin me të gjitha format sipas hapësirave ligjore.

Dh.Gegprifti

## Reportazh

# Mbresa nga Tushemishti

Nuk mërzitem të shkruaj për Tushemishtin, por dhe lexuesit dhe banorët e tij duan që të shkruhet për të. Ai është kthyer në një qytezë të gjallëruar. Por më tepër, në sezonin turistik. Virtytet këtyre banorëve janë: bujaria, modestia, rregulli dhe pastërtia. Dhe s'ka se si të ndodhë ndryshe, kur në 2-3 muajt e nxehtë të verës, tushemishtarët me familjet, lokalet dhe hotelet e tyre luksoze hapin portat për mijra pushues vendas dhe të huaj.

Me disa prej tyre që vijnë çdo vit këtu, ata kanë krijuar lidhje familjare.

Një ndër ta është edhe shkrimtari i mirënjohur Dritëro Agolli me familjen e tij, i cili çdo vit kalon pushimet tek Pandi, në hotel

"Millenium". Por këtu nuk mungojnë për të pushuar apo kaluar disa ditë pushimi dhe politikanë si Spartak Braho, Skënder Gjinushi, etj, pa veçuar dhe shkrimtarë e gazetarë si: Aida Shtino, Fahri Balliu, Natasha Lako me bashkëshortin e saj Mevlan Shanaj etj. Por dhe pushues të thjeshtë, kalojnë ditë të qeta dhe të bukura duke marrë rrezet e nxehta të diellit përvëlues, por që më pas freskohen në ujët e freskët dhe të ëmbël të liqenit kaltërosh.

Po kënaqësia më e madhe për ta është mbrëmja, kur dielli perëndon, dhe era e freskët e malit të Thatë futet në dritaret e hapura. Pushuesit në Tushemisht gjejnë gjithçka që u duhet: dyqanet janë të

mbushur plot dhe nuk mungojnë shitësit ambulantë të gazetave, të lodrave të plazhit për fëmijët e pushuesve, fruta-perimeve etj. Ditët e javës ikin ashtu papritur, pa u ndierë dhe pushuesit duan të rrinë dhe të rrinë... por një ditë ata do të largohen për në familjet e tyre. Është fund gushti. Vapa e nxehtë e muajve të verës dalëngadalë ia lë vendin freskisë së vjeshtës, dhe pse në fund gushti "kërcënon" përsëri me temperaturë të lartë. Makinat e shumta që kishin vijëzuar trafikun prej Drilonit deri në afërsi të doganës së fshatit, si dhe sokëllimat e borive të tyre, duket se do të mungojnë gjatë, deri në verën e ardhshme.

Moria e pushuesve kanë boshatisur shtëpitë e

tushemishtarëve, si dhe lokalet dhe hotelet luksoze të tij. Në fshat zotëron tani një qetësi absolute. Por ende në plazhet private duken të shtrira shezlonet portative me çadrat e tyre.

Në rërën e imët sheh gjurmë të mbetura nga plazhistët. Liqeni i qelqtë përkundet si djep nga dallgët e lehta, duke u liruar nga pesha e pushuesve dhe mjetet e rënda motorike.

Të gjithë pushuesit mbasi largohen nga Tushemishti lenë tek banorët mbresat e mira të tyre, por dhe marrin prej këtyre banorëve kujtimet më të mira, marrin me vete bukurinë magjepsëse të liqenit të kaltër, flladin e freskët dhe të shëndetshëm të malit të Thatë, por me dëshirën e madhe që verën e ardhshme të pushojnë prapë këtu buzë liqenit, në Tushemishtin e malit të Thatë.

Esat Berberi

Kjo ndërtesë ka tetëdhjetë e ca vjet që ka ngulur themelet e veta në truallin korçar dhe bën dritë dhe hije buzë bulevardit "Republika"

# Majestik –një legjendë e kulturës korçare

**Vangjush Ziko**

Shfletoj fjalorin e gjuhës frënge dhe fletët e kujtesës sime. Fjalori ma përkthen këtë fjalë. Kujtesa ma sjell ndër mend. Përfytyrimi ma rikrijon. Kinema "Majestik". Kafene "Majestik". Salloni "Majestik". Sheshi "Majestik". Madhështi. Madhështor. I Madhërishtëm! Nuk bëhet fjalë për titull aristokratik apo për pallat mbretëror. Bëhet fjalë për një ndërtesë në një nga sheshet e qytetit tim, ndërtesë e lartë dykatshe me një sipërfaqe ndërtimi rreth gjashtëqind metra katrore, të lartë katërbëdhjetë metra, me një faqe ballore të veçantë, ku forma drejtkëndore është plot dritare karakteristike të stilit dekorativ, me vitrina anësore të mëdha, plot dritë dhe një ballkon të harkuar. Çatia e saj është e mbuluar me llamarinë, që mban mbi vete shkëlqimin dhe bllanat e kohës.

Kjo ndërtesë ka tetëdhjetë e ca vjet që ka ngulur themelet e veta në truallin korçar dhe bën dritë dhe hije buzë bulevardit "Republika". Dora njerëzore, jo vetëm e ka lyer dhe zbuluar shumë herë, jo vetëm e ka meremetuar, por edhe ka ndërhyrë duke ia shndërruar fatkeqësisht strukturën e saj të brendshme. Barbare ishte ndërhyrja në vitet gjashtëdhjetë kur salla e kinemasë, e projektuar dhe e ndërtuar në miniaturë sipas modelit të "La Skalas", me plate, llozha dhe ballkon, u kthye në një sallë të rëndomtë kinemaje.

Dekoracioni i mjedisve të brendshme ka ndërruar disa herë për arsye objektive ose subjektive. Kështu, salla e kinemasë u bë dhe sallë teatri dhe koncertesh, u bë sallë mbledhjesh solemne dhe gjyqesh të rëndomtë, ring boksi e tapet mundjesh, bingo... Kafeneja aristokratike u bë klub i zakonshëm dhe... dyqan mobiljesh.

Salloni i gjerë i katit të dytë, nga sallë dansi, u shndërrua në teatër kukullash dhe bilardoje. Ndërsa, gjithë ndërtesës iu ndërrua disa herë emri nga "Majestik", në "Morava", bingo "Olimpia", "Milenium"... duke kërkuar gjithmonë emra vargmalesh ose malesh përëndish për të mos iu shmangur,



për t'iu afruar emrit me të cilin e pagëzuan bashkëpronarët e saj kulturëdashës, që me ndërgjegje të plotë e projektuan si një objekt social-kulturor, si një vatër kulture dhe çlodhjeje për qytetin e tyre. Por, asnjë emër nuk mundi t'i shkonte më mirë kësaj ndërtesë të veçantë se sa emri fillestar, që e ka vulosur vetë koha, MAJESTIK-MADHËSHTOR!

Madhështia e kësaj ndërtesë qëndron jo vetëm në pamjen e saj të jashtme masive dhe karakteristike, arkitektonike, por edhe në kujtesën e saj të ngurtësuar në vite, që ka regjistruar shijet, nivelin kulturor, frymën emancipuese të një qyteti të tërë, që ka përjetuar dhe përjeton kohë të ndryshme historike: kohën e Mbretërisë, të Luftës së dytë Botërore dhe pushtimit fashist, të Socializmit dhe të Demokracisë. Në këto dekada kinemaja është bërë një vitrinë e kulturës, artit, sportit, politikës dhe zakoneve të jetës korçare; atje breza të tërë kanë thithur nektarin apo helmin e kohës, kanë shprehur simpatinë apo antipatinë e tyre, kanë duartrokatur apo kanë përplasur këmbët, kanë dalë të gëzuar apo të hidhëruar, të qeshur apo të përbotur, entuziastë apo pesimistë; me një fjalë të vetme, kanë jetuar.

Në kafenenë "Majestik", ku,

bashkë me aromën e kafesë dhe hidhërimin e nikotinës, nëpër tavolina lexohej shtypi i përditshëm, thithej jehona e politikës dhe e kulturës kombëtare dhe asaj botërore. Atje është diskutuar për mbretërinë, për fashizmin dhe komunizmin, për Hitlerin dhe Çurçllin dhe Stalinin, për Fan Nolin dhe Ahmet Zogun, për Mit'hat Frashërin dhe Enver Hoxhën... Më pas në vite, atje familje të tëra korçare kanë festuar dasmat e tyre ose kanë pirë verën e hidhur të përshpirtjeve. Në perden e bardhë të kinema "Majestik" është pikëlluar ose lumturuar Greta Garbo dhe Alida Vali, Çaplioni i madh dhe Olio me Stenlion; Ladinina dhe Druzhnikovin, Naim Frashëri dhe Pandi Raidhi; ka parakaluar kinematografia botërore dhe ajo kombëtare e tërë atyre dekadave... Në skenën e saj ka jehuar zëri i magjishëm i Tefta Tashkos dhe është luajtur opereta e parë shqiptare e kompozitorit Kristo Kono; ka kënduar Kori Karakteristik i drejtuar nga Kostaq Osmanlliu dhe Ansambli Artizan i Pavllo Shollës. Në këtë skenë është luajtur Molieri dhe Ibseni, të inskenuar nga pionieri i regjisurës shqiptare, Sokrat Mio... Në ringun apo në tapetin e përshtatur në skenë, i madhi Petro Sturgji, kampion bote në mundje, ka zhvilluar ndeshjet e tij emocionuese,

Dora njerëzore, jo vetëm e ka lyer dhe zbuluar shumë herë, jo vetëm e ka meremetuar, por edhe ka ndërhyrë duke ia shndërruar fatkeqësisht strukturën e saj të brendshme. Barbare ishte ndërhyrja në vitet gjashtëdhjetë kur salla e kinemasë, e projektuar dhe e ndërtuar në miniaturë sipas modelit të "La Skalas", me plate, llozha dhe ballkon, u kthye në një sallë të rëndomtë kinemaje

kurse veterani i boksit kombëtar, Rafail Dishnica, është ndeshur denjësisht edhe me boksierë të huaj...

Dhe, për ironi, në këtë skenë diktatura do të improvizonte jo vetëm konferencat, por edhe gjyqet famëkeqe të luftës së klasave... Në sallonin "Majestik" dhe në kujtesën e korçarëve nuk do të shuhen kujtimet tingëlluese të ballove voskopjare me shkëlqimin dhe elegancën e tyre pariziane, bashkë me jehonën e koncerteve vokale-instrumentale të grupit të paharrua "Lyra", të viteve tridhjetë, që i mbyllte shfaqjet e veta, duke kënduar bashkë me publikun korçar të entuziazmuar e të ngritur më këmbë këngën "Natën e mirë... o shpirti im"! Sheshi "Majestik" është dëshmitari i nisjes apo pritjes të garave çiklistike kombëtare; të procesioneve gazmore të karnavaleve korçare, të mitingjeve dhe demonstratave të ndryshme...

MAJESTIKU me mjediset e tij të brendshme dhe ato të jashtme, mbetet një dëshmi unike e arkitekturës, kulturës, artit, sportit dhe të jetës së qytetit tim, pse jo edhe asaj shqiptare të shekullit të njëzetë. Korça dhe korçarët dëshirojnë që ai të përcjellë denjësisht dhe mijëvjeçarin e ri që porsa ka filluar!

**Vangjush Ziko**

Homazh për mjekun **Kalam Tako**

# Mjeku që ngriti spitalin e Himarës

*Si e shpëtoi profesorin e biologjisë Babi Ruçin, nga pickimi i gjarprit*

Para pak kohësh, një fëmijë 5 vjeç vdiq nga pickimi i gjarprit në spitalin e Korçës. Vdiq para syve të mjekëve. Një shëmti e punës së tyre. Pakujdesi. Paaftësi. Fëmija vdiq në një nga spitalet me emër të mirë dikur. Faj apo gabim i mjekëve?! Po ka patur dhe raste që ata nuk e kanë shkelur betimin e Hipokratit dhe kanë bërë të pamundurën për të shpëtuar jetë njerëzish. Ndër vite mjekësia nuk ka qenë kjo e sotmja. Mjekë të përkushtuar në punë e në zanat, në kushte të vështira, pa aparatura dhe barna, në një nivel të ulët kulturor të komunitetit kanë çarë me dijet që morën nëpër shkollat jashtë shtetit, duke lënë emër në historinë e mjekësisë sonë. Një mjek i tillë ka qenë dhe Kalam Tako, i diplomuar në Bolonja të Italisë.

Ishte i shkëlqyer në matematikë dhe profesorët i rekomanduan që të bëhej mësues matematike apo edhe inxhinier. Ai si dëshirë të tij të vetme kishte që të bëhej një mjek i mirë dhe t'u shpëtonte jetën njerëzve. Në vitet e rinisë së tij nuk kishte pengesa për të zgjedhur degën që dëshiroje. Pengesa ishte tek gjendja financiare dhe mungesa e shkollave të larta brenda vendit. Duke parë tek djali i i tij rezultate të larta në mësim, babai nuk e ndaloi që ai të ndiqte studimet e larta për mjekësi.

## Kush ishte mjeku Kalam Tako

Kalam Tako u lind në fshatin Novoselë të Përmetit në vitin 1904. Studimet e para i mori brenda vendit. Shkollën e mesme e kreu në ishullin e Korfuzit të Greqisë. Nga lëndët e shkollës së mesme e tërhiqte

matematika dhe profesorët e atyre viteve në Korfuz i kishin thënë Kalamit që të studionte për inxhinier apo të bëhej një mësues matematike, koleg i tyre. Nga llogaritë që Kalami kishte bërë i kishte dalë më mirë rezultati për t'u bërë mjek, nuk do të studionte as për matematikë, as për t'u bërë inxhinier. Dëshironte të bëhej mjek.

Studimet e larta i përfundoi në Universitetin e Bolonjës në Itali në vitin 1939 me specialitetin mjek patolog dhe kirurg.

Në diplomën e tij ishte shënuar: "Dottore in medicina e chirurgia." Njohës i gjuhës greke, franceze dhe italiane.

## Nisja e punës si mjek i lartë

Që nga viti 1939 deri në vitin 1945 ai punoi si mjek në qytetin e Përmetit. Ngriti spitalin e Përmetit. Vitet e punës përkujtojnë me vitet e luftës së përbotshme. Mjekoi të plagosurit nga lufta. Nuk do të rrinte më në Përmet sepse e nisin për në spitalin e Vlorës. Qëndron pak kohë në këtë spital dhe udhëtimi i tij do të ndalej në Himarë. Do qëndronte në Himarë plot 9 vjet duke patur dhe familjen me vete. Ngriti dhe stabilizoi spitalin e këtij qyteti. Po puna e tij nuk mbetej vetëm brenda në Himarë. Në këmbë ditën e natën ai do të udhëtonte fshatrave përreth. Punoi jo vetëm si mjek patolog, por edhe si kirurg ambulator, si gjinekolog, pediatër dhe mjek ligjor. I diplomuar jashtë shtetit emri i Kalam Takos ishte në listën e intelektualëve "të rrezikshëm" për pushtetin popullor.

## Mjeku bëhet me djalë

Pas katër vajzave mjekut në Himarë i lind djali. Himariotët e bënë festë atë ditë kur i vunë emrin djalit të doktorit. Kalami nuk ishte vetëm mjek për himariotët. Ai u bë mik e shok me ta. Puna e tij në Himarë ishte tepër e lodhshme, sepse ishte i vetmi mjek në të gjithë krahinën. Ai udhëtonte në

këmbë, hipur në kuaj në të gjithë fshatrat rreth Himarës. Do të shkonte në Dhërmi, Palasë, Vuno, Qeparo, Pilur, Kudhës, Borsh, Piqeras.

## Kujton e bija

Zhaneta e martuar në Korçë, tani mësuese pensioniste sjell ndërmend punën që bënte babai i saj si mjek në Himarë.

"Babai ishte gjithnjë i preokupuar dhe në lëvizje sepse duhej që të punonte si mjek polivalent. Shpërblimi i punës së tij ishte mirënjohja e njerëzve, të cilët e ruajnë edhe sot. Para dy vitesh kur shkova të kaloja pushimet e verës në Himarë, u befasova dhe u emocionova nga pritja që më bënë himariotët. Më erdhën e më shtrënguan dorën duke u përplotur e duke kujtuar episode nga jeta e babait tim. Për himariotët babai nuk kurseu as shëndetin e tij. Himariotët nuk e ndanë babanë nga sofrat familjare. Ata e quanin djalin e çdo familje. Ditën kur doktori u bë me djalë, pas katër vajzave, ishte në festë e gjithë Himara. Atë natë dritat nuk u shuan deri në agim. Ne fëmijëve nuk na ushqeu kurrë ndjenjën e mendjemadhësisë, sepse ajo është një këshilltar i keq për karakterin e njeriut. Si pasojë e një jete me ngarkesë të madhe pune me vështirësi e pengesa në terrene, shkaktuan tek babai tronditje e plagosje të rënda shpirtërore. Kërkoj të transferohej në Korçë, për klimën e favorshme për shëndetin e tij. Erdhëm, por na rikthejnë përsëri në Vlorë. Unë isha 13 vjeçe dhe më kujtohet babai i lodhur dhe i mplantur që mezi mbushej me frymë nga lodhja dhe vapa e Vlorës. Në Vlorë jetuam tre vjet dhe babai ishte gjithnjë i sëmurë, por kujdesi i tij si prind nuk mungoi për ne fëmijët. Qeshte me humorin e artistëve vlonjatë. Ne do të ishim gjithmonë në kinema, kur jepeshin premiera, do të ishim të parët për të parë pjesët e reja

të estradës së Vlorës. Dilnim në plazh dhe babai na blinte akullore.

Në pranverën e vitit 1959, vdekja i rrëmbeu jetën mjekut, babait tonë, Kalam Tako, në moshën 54-vjeçare. Në ato ditë të vështira e të dhimbshme na u gjendën pranë shokët e babait Dr.Pavillo Filloko (babai i Timo Fillokos), Dr.Pustina, Dr.Kauri. Nuk mund të harroj himariotët e shumtë që erdhën në varrimin e babait."

Thanas Çakalli nga Piluri kujton:

"Kishim babanë sëmurë rëndë. Shkuam në Himarë dhe kërkuam ndihmën e doktor Kalam Takos. Pa hezitim ai pranoi kërkesën tonë që të vinte në Pilur. Udhëtuam nga Himara deri në Pilur në këmbë. Qëndroi tek koka e babait dhe pasi e vizitoi i dha ndihmën mjekësore me barna, të cilat nuk i mbaj mend. Më kujtohet, kur na tha: Nëse i sëmuri do të vjellë një përmbajtje me shije të kripur do të shpëtojë. Ndodhi kështu. Babai shpëtoi nga vdekja. E shpëtoi mjekimi i doktor Takos."

## Emri i përmendet në Institutin Pedagogjik të Shkodrës

Kishin kaluar 12 vjet nga vdekja e mjekut Kalam Tako. Në vitin 1971 vajza e tij e vogël, Elvira Tako nisi studimet për mësuese biologjie dhe kimie në këtë institut. Në orën e leksionit të Sistematikës së Bimëve, që e jepte profesor Babi Ruçi ndodhi një fenomen që rrallë ndodhte me këtë profesor në orët e leksionit. Ai bën apelin e studentëve dhe kur arrin tek studentja Elvira Tako ndalet dhe ngre kokën e hedh vështrimin nga salla e leksionit.

"Kam njohur një mjek me këtë mbiemër, që ka shërbyer në Himarë. Keni lidhje familjare?" e pyet studenten.

"Po, ai mjek ka qenë babai im."

"Ka qenë, pse nuk është më?"

"Ka vite. Po mbushen 12 vjet që na ka lënë".

Profesori e harroi leksionin dhe u zhyt në kujtimet e fëmijërisë së tij.

"Kur isha fëmijë kafshimi i një gjarpri më rrezikoi jetën seriozisht. Jetën e kam nga ndihma e shpejtë që më ka dhënë doktor Kalam Tako. E dini si ma shpëtoi jetën? E thithi helmën nga plaga me gojë. Ma nxori nga trupi mua dhe i shpëtova vdekjes."

Pëllumb Çuni

## Reportazh – rrëfim

# Me dr. Jani Bashon e prof. Sazan Çeliku në Shën Marenën e Mokrës!

Me rixhanë e dëshirën e shprehur nga dr. Bashua e shokut e mikut, prof. Sazan Çeliku dhe familjarëve të tyre në datën 18.07.2009, u bë ky udhëtim e piknik në atë vend të shënjtë. Si pelegrinë, me dashuri ndaj Zotit, njerëzve e natyrës të atij vendi të shumëvizituar mbërritëm atë të shtunë të paharruar. Manastiri ndodhet mes bukurive që krijon Kurora e gjelbëruar e Valamarës dhe pyjet e Bishnicës, oshëtima e rrjedhës së ujrave të Eordejit të lashtë. Më tej ndehet Kozici, Mali i Perëndive ose “babë Kozici”, që ofron dashurinë e njerëzve të kësaj ane, për traditën, zakonet, shijen e mishërave të pjekur në ato vendburime dhe kuleçët e grunjtë. Hojet e piteve të mbushura me mjaltë.

çudibërës, shërues, që prodhon natyra në atë bimësinë e saj, e përpunuar “me duar të arta” nga bletët që jetojnë e mbarshohen në këto vise. Arrihet pastaj kulmi me atë bujarinë e sofrës mokrare, disa gota të pira me fund, plot me verë a raki, nën komandën e dollibashit, që afron me një “dash që prin kopenë”; gota plot, në dorën e tij, ngjason si ajo këmbora që i qëndron e varur në qafë e duhet tundur; të tjerët, janë të lutur e të detyruar ta dëgjojnë e respektojnë pa fjalë shumë dhe bile jo ta ngrejë kokën shumë, po t’i pinë gotat si të bëjë hyqmë dollibashi me plot, ashtu de! Shpesh të shtruar këmbë kryq, sikurse ne, këtu në shën Marenë e Ergjëndtë të Llëngës e Mokrës, i paçim uratën! Kështu thuhet nga besimtarët e shumtë të saj, bujarë e me besë.

Dhe unë, si pjestar në këtë ekskursion, do të mundohem edhe të përshkruaj itinerarin edhe të rrëfej e tregoj gjithçka të ndodhur në këtë piknik.

Nisja u bë nga dalja e qyteti të Pogradecit e vazhdoi rrugën nëpër



fshatin Vërdovë, që dikur përfaqësonte identitetin e traditat e tërë krahinës. Më pas makina mori përpjetën e dolëm lart në Varret e Grekut, emër që mbahet nga të varrosurit, të rënë në luftën e dytë Italo - Greke.

Më pas rruga mori për tatëpjetë dhe ne mbërritëm në fshatin Kalivaç të Mokrës, me banorët paraardhës nga Kalivaçi i Tepelenës, komunitet ky që dëshmojnë edhe si vlerë e shtuara për Mokrën. Pasi lamë fshatin dhe malin që bart mite të perëndive, legjenda, “thesare të fshehur”, dikur mitropolia Mokër-Gorë me shumë kisha e ujëra shëruese, arritëm në Podgozhan, ku makina u ndal për të marrë përshëndetjet nga një banor, mokrari Miallaq Burnazi me një kulaç të porositur për këtë piknik. Kur pa e njohu dr. Jovan Bashon. Si na dha të gjithëve dorën i tha atij veç të tjerash: “Doktor, ti je i yni!” dhe doktori e pohoi duke iu përgjigjur: “Po të gjithë tanët jemi!”

Si shtrënguam duart, makina vazhdoi rrugën, duke lënë në të sipërm, Malinën e Trebinjën.

*Manastiri ndodhet mes bukurive që krijon Kurora e gjelbëruar e Valamarës dhe pyjet e Bishnicës, oshëtima e rrjedhës së ujrave të Eordejit të lashtë. Më tej ndehet Kozici, Mali i Perëndive ose “babë Kozici”, që ofron dashurinë e njerëzve të kësaj ane, për traditën, zakonet, shijen e mishërave të pjekur në ato vendburime dhe kuleçët e grunjtë. Hojet e piteve të mbushura me mjaltë.*

Makina u var tatëpjetë e zbriti në lumë e më pas, përpjetë drejt Çezmave, Hondishtit dhe dolëm së fundi në Mujaza. Ndali kur arritëm lart te kryqi. Gjatë rrugës, patëm mundësinë të bisedonim e të mësonim nga doktori pasionin në rini për sportin e skive. Kish qenë shpesh në ato dimra me disa shokë të atyre viteve në livadhet e

Podgozhanit. Mësuam për pasionin e tij për filatelinë dhe se vazhdonte të ishte një koleksionist i vjetër e serioz. Trashëgonte një koleksion të pasur e të rrallë pullash postare nga i ati, i paharruari Kozma Basho. Nga rezervuarët e Mujazës dukej fshati, dikur qyteza, e Llëngës, tashmë gati e braktisur. Na bëri përshtypje se po shfaqen shpresa për ta rigjallëruar, se banorët e pakët kishin ngritur një kishë të re, kishën e Shën Gjergjit, ndërtuar me kontributin e fshatarëve, të shpërngulurve e me mbështetjen financiare edhe të Ambasadës Rumune në Tiranë. Mësuam se z.ambasador kish qënë me origjinë nga ky fshat, nga fisi i Pihonave, dhe ishte shprehur se do jetë i pranishëm në Llëngë e Shën Marenë gjatë këtij sezoni veror. Dr. Bashua vlerësoi atë punë të mirë dhe u shpreh se me të drejtë ka ndihmuar ambasada Rumune, se besimi fetar në këto anët tona i të krishterëve orthodhoksë e ka rrënjën nga qyteti dhe kultura 2400 vjeçare dhe kisha e Patriarkana e qytetit të lashtë të Beratit, me ata kodikët e shënjtë të rrallë në botë, prej nga vareshin kishat e manastiret e kësaj treve përfshi Ohrin, Voskopojën, Vithkuqin (jo nga kisha e Partiarikana Greke). Kjo është dhe arsyeja që nuk investohet e restaurohet kjo pasuri e kulturës tonë kombëtare. Ndërsa gjatë gjithë kësaj kohe prof. Sazan Çeliku jepte dhe merrte me Ismailin për ato qindra e mijëra lloje e soje luluri bimësh medicinale që ne parakalonim.

“Besoj se nuk do jenë të njohura as edhe nëpër sistematikat e bimëve”, kështu që profesori i hap punë vetes edhe në kthim. Do t’i duhej të plotësojë kushedi sa bimë të munguara në sistematikën e Karl Lineut. Mbërritja u bë shëndoshë e mirë në destinacion, por tani na prisnin detyra të tjera për të

plotësuar dhe përmbushur tamam shartet e këtij udhëtimi. Detyrat ishin: therja e mishit të kurbanit, marrë i gjallë me këmbët e tij, pjekja e tij për shtatë palë qejfe, më pas ndarja, denetisja sipas vendit e nderit dhe së fundi këndimi i shpatullës së kurbanit nga “orakulli”, në prani të shokëve e pjestarëve. Pak veta e kanë dhunti këtë marifetin e njohjes së shpatullës.

Nga përvoja dihet se labët janë mjeshtra për ta pjekur mishin e shijuar atë. Ky është mendimi i im për lebët në këtë lëmë, po ne do ta shikojmë dhe vlerësojmë pa anësi në këtë sofrën tonë këtu, në hijen e manit shekullor, të shpallur monument kulture në këtë vend të bekuar.

Dua të them se pjesëmarrësit fillimisht, pasi u qetësuan, shkuan në kishë ndezën qirinj e u lutën e falën me besim në një Zot. Doktorit me fëmijët shkuan poshtë, te Shpella, vend strehimi i shenjtores Marena, ku morën copa guri dhe bënë fotografi. Më pas vizituan varrin lapidar të papa Kostandin Pihonit këtij kleriku patriot, komandant e bashkëpunëtor kryesor për çështjen kombëtare, nga Lidhja e Prizrenit, shkollat e para shqipe, në ngritjen e flamurit dhe deri në Kongresin e Lushnjës me Shahin Matrakun, Kajo Babjenim, Tun Kokoneshin, trimat Luli e Braho Dunica, Torrat, Zallorët, Gjatollinjtë, Gjerasim Qirjazin, Gjergj Pekmezin, Gjokë Pjetër “Shqiptarin”, Tushi Milo Paskon, Ligor Kërzhallin<sup>1</sup>.

Më pas doktori me fëmijët e tij shkuan dhe u freskuan në vendburimin uxor të bekuar, të Najazmës. Profesor Sazani tregoi interes dhe për diçka tjetër. Shkoi vizitoi dhe konakët, dikur Karvan Sarajet e manastirit. Më pas ai ish spital partizan e vend qëndrimi i misionit anglez, i cili është lënë në gjëndje të mjerueshme.

Më pas, në shoqërinë e Istref Haxhillarit e Ismail Xhajës pimë nga një kafe e nga një gotë raki te lokali i Manastirit. Aty u pritëm e na u urua mirëseardhja nga kujdestari i Manastirit, Nasi Tona, në mungesë të priftit, papu Degërmenit nga Pleshishti i trimave të Mokrës, që nga bashkëluftëtarët e Skënderbeut, Angjelini, pastaj Naum Shyta (mik i besës i Ali Pashës), Gjokë Shqiptari, e shumë atdhetarë edhe



## Me dr. Jani Bashon e prof. Sazan Çelikun në Shën Marenën e Mokrës!

të luftës Nacionalçlirimtare. Më pas shkua për të drekuar. Si zumbë vendet të gjithë pjesëmarrësit, të shtruar këmbë kryq në lëndinë, zonjave të nderuara dhe fëmijëve të tyre u sugjerua të zinin vend më afër vendndodhjes së kishës së Shën Marenës dhe më pas vinin të tjerët. Me vendin e “mikut të parë” u nderua prof. Sazani. Përkrah vinte dr. Jani dhe nga “të zotët e shtëpisë” ishin Ismail Xhaja, Istref Haxhillari, Koço Pihoni e Vasfi Sheri. Ndërkohë, qilarxhiu urdhëron ndihmësin e tij, “dajon” e fëmijëve të Xhajës, të sjellë shishet me pije raki, verë, birra e pije freskuese, të cilave iu shtuan dhe dy shishe verë e sjellë nga Italia në Tiranë e prej andej në Shën Marenë nga dr. Bashua. U mbushën gotat dhe u urua mirëseardhja e u dha leja e pirjes të disa gotave të tjera sipas dëshirës. Ndërkohë, me porosi të qilarxhiut, mbërriti si për “këmbë e parë”, zoti “Kulaç i Mokrës”. Gjatë kohës po vinin kurbanit, mishi i pjekur dhe një tavë me peshk, koran lumi. Pastaj erdhën bostanoret dhe disa mëshere djathi që e shoqëruan dhe e plotësuan atë drekë a gosti. Në këtë sebeb fjala e “çeljes” iu dha zotit “kulaç” i cili iu drejtua atyre

zonjave të nderuara të ndodhura aty tok me ne e u thoshte:

Të më bëni me grurë vendi, | Sita të jetë me dy faqe, | Çupat, Nusët që hynë në magje, | Të jenë faqe kuqe, jo ngordhalaqe, | Të më piqni në oxhak, me dru fshatëshe | Të më përdorni në sebepe e gostira, | Me thikë mos më prisni, po me dorë të më thjeni e ndani, | Me mish të pjekur, bulmet e mjaltë të më hani, | Të bëni qejf, të pini verë, raki rrushi a kumbulle dy herë zjerë, | I tëri i Mokrës jam, po folenë, atje, në Podgozhan e kam.

Fjalët e tij ishin mbajtur parasysh dhe zbatuar pikë për pikë. Më pas, radha i erdhi dollisë, asaj kushtetute të mokrarëve, që pak popuj në botë e njohin dhe e nderojnë. Po të njihej dhe zbatohet në veri, shumë gjaqe do gjenin zgjidhje. Mbas urimit nga të zotët e shtëpisë, dollinë e mikut e bëri profesori Sazani. Për ta ndihmuar, me detyrën e sekretarit u ngarkua zoti Istref. Dollia shkoi mirë. E rëndësishme ishte dhe ndarja e mishit. “Nishanet” u vendosën duke respektuar së pari ato zonjat e nderuara. Këtu bëhej fjalë për kokën, shpatullën, pjesën e bishtit. U nderuan zonjat, i ka demokracia këto!

Dreka, më mirë nuk kish ku shkante, me dolli, me shumë urime, bejte e këngë të vjetra poradecare, shumë rrallë të dëgjua, të kënduara veçmas nga dr. Bashua në shoqërinë e të tjerëve. Ishte kënaqësi tani të shikoje dr. Bashon çakërcej! Ne nuk na besojnë e kur jemi esëll e fil fare. Kur nuk i vinte aq në terezi thoshte, “Po dalë bre i uruar!”, “Po jo bre!” Disa herë u përsërit një këngë e vjetër “Care dil ne porta”, shënja klinike këto të qarta për ta vënë diagnozën saktë, se ishte bërë qejfi tamam. E kënduam dhe ua mësuam një grupi çunash, studentë të ardhur si ne nga Pogradeci.

Sa e vërtetë është kjo, mund t’u besoni fotove të shkrehuar atje. Me siguri ato flasin shumë, janë foto me “zë”. Besoj se në gjithçka do duket se muhabeti shkoi si jo më mirë. “Orakulli” kërkoi, nëse dëshironim të dinin e dëgjonin ç’i thoshte atij, shpatulla. Të gjithë dhanë pëlqimin. Ai u betua se do thoshte të gjitha të thënat, të shkruara atje për çdonjërin përfaqësues, në prani e të bashkëshorteve të tyre. Sakaq u urdhërua dajua të shkante të nxirrte e të merrte nga uji i shatërvanit një

vijon në faqen 10

# Me dr. Jani Bashon e prof. Sazan Çelikon në Shën Marenën e Mokrës!

vijon nga faqja 9

“kurban të dytë”, ky një bostan i madh sa një “kungull Stambolli”, po i kuq flakë e më i ëmbël se mjalti. Më pas “orakulli” u bë serioz.

Fjalët e para të dala nga goja e tij ishin për të zotin, kurbanbërësin, z. Ismail Xhaja. Sipas shenjave sekrete e mistike që vetëm ai dinte t’i deshifronte, për çdonjërin, në atë pjesë të shpatullës, ku rrëfehej ç’kishte rezervuar fati për të ardhmen dhe ç’gjynahet ka bërë e duhet t’i rrëfej. Në fillim të kësaj pune u thashë të pranishmëve që t’ja venë mirë veshin fjalëve e të studionin ç’ka rezervuar fati për ju. Duhet ta vlerësoni se ndryshe e paguani me dhjetë fish më shtrenjtë! Për ilustrim u rrëfeva një rast, ku dikujt i dilte në shpatull se do ta gjente gruan të sëmurë keq për vdekje, po të mos i qeraste ata shokët që ndodheshin aty me një shishe raki. Jeta e gruas së tij ishte në rrezik, e gruas që ai e deshte aq shumë, sa dhe kur betohej, për kokën e saj zinte, sikur ta kishte bir të vetëm. Këtë rrëfim, ky zotnia nuk e mori seriozisht. Kur shkoi në shtëpi, u trondit, se vërtetë gruaja ishte shumë keq. Urgjentisht shkoi mori doktorin më të mirë dhe ai nuk po kuptonte gjë. Atëherë ky burrë u kujtua ç’i thoshte atij shpatulla dhe nxitoi e shkoi te “orakulli” me një shishe raki dhe i ra ndër gjuhë duke iu lutur sikur ai të kish qënë Jezu Krishti dhe i thoshte: “Aman, të lutem, të puth këmbë e dorë, bëj derman për mua e gruan time të gjorë.” Orakulli u ngrys pak, u mendua dhe i tha: “Je shumë me vonesë tashmë. Që të shpëtosh nuk bën fajde një shishe, por duhet një damixhan me raki”. Hallemadhi nuk priti, por me të shpejtë shkoi e bleu. Kështu shpëtoi gruan, që e ka shëndoshë e mirë e sot e kësaj dite. “Po juve jeni të lutur, ju bëj rixha, që mua të mos më nxirrni në mejdan, se po e muarën vesh që Koçua i Tashkut ua di fundin shpatullave, hajde e bëj punë me

këtë millet. Ca e kanë nga halli e duan të dinë si i kanë punët, po ka dhe shumë të tjerë që e kanë nga qejfi, duan të dinë për fatin.” Shumë mirë thonë fjalët e asaj këngës: “Fatit mos iu zemëro, po i thuaj të të trokasë qoftë dhe një herë në derë, po s’ja hape portën, le të ikë e le të mos kthehet tjetër herë”. Tashti ju lutem më dëgjoni.

- Ismail, ty të del në shpatull se i mban një të fshehtë të vjetër, të pathënë gruas tënde. Bën mirë t’ja thuash, ndryshe do t’ja them unë, kështu si del këtu. Ti, në të ri, ke dashur të lidheshe me një vajzë të krishtere nga kjo anë, por kjo dëshirë nuk të është plotësuar. Këtu del se së shpejti, brenda këtij viti, do të kesh një kurorë në shtëpi. Nusja që do hyjë në shtëpinë tënde del e besimit të krishterë. Këtu në shpatull, më rezulton se ti i ke marrëdhëniet më mirë me Perëndinë se me qeverinë. Shumë para dalin këtu me duart e tua, po nuk thuhet e dihet akoma, se ku qëndrojnë këto para? Dëgjomë mua, paratë e gjynahet, bën mirë mos të t’i dijë gruaja e bota edhe kur ke edhe kur nuk ke. Këtu më del se, në qoftë se ti dëshiron të bëhesh edhe një herë kryetar në këtë vend e këto anë, provoje e ke të fituar. E thotë shpatulla e unë ve garant kokën time!

Ndërhyt Ismail Xhaja:

-Unë kandidoj, po me një kusht. Po fitova unë, ti duhet të vish edhe një herë në Mokër dhe bashkë të kontribuojmë për blegtorinë.

- Kaq më thotë shpatulla për ty, besoj janë të mjaftueshme për këtë vit o Malo, o “trim”, të vafitë puna mbarë. Tashti të vazhdoj me mikun, profesorin tonë të nderuar zotin Sazan Çelik.

- Me sa di unë, ju jeni bektashian dhe po të shikosh në këtë rreth miqsh kjo shënjtoje i afron, i do pa dallim dhe e lutin të gjithë si e kanë në zëmër. Shiko këtu dr. Bashua e ka gruan myslimane, Ismaili tjetër



besimi e ka dashur, tjetër besimi ka marrë, unë e pata myslimane, tashi feston më shumë ritet e “besimit më kryq”. Juve jeni bektashjan, zonjën tuaj nuk e di dhe as marr guximin ta pyes, zoti Istref, megjithëse në romanin e tij “Pesha e Kohës” është shprehur e insiston me të madhe se “Njeriu për një nder rron” sot ndjehet ngushtë, teksa nuk e nderon bashkëshortia këtu, paçka se mungon për arsye shëndetsore. Zoti Istref shprehet:

- Jam absolutisht kundër martesave gej, po nuk do isha kundër lejimit të martesës së një burri me dy gra, se ja si ndodh e turpërohet njeriu!

Zoti Sazan, këtu më del se kurbanbërësi ju ka mik për kokën e miku, ju nderon si pak të tjerë dhe paska vërtet të drejtë. Kaq dhe për ju o mik i dashur, i nderuar e respektuar, je shumë i mirë, ti vlen!

Doktor Basho, thonë se radha vonon, po nuk harron. Juve jeni mësuar të shikoni si zenë radhë për t’u vizituar tek ju. Sot besoj e provove deri sa t’u desh të presësh për të të ardhur radha., kjo besoj mjafton për të kuptuar sa i rëndësishëm jam unë! Për ju

(Shënim) <sup>1</sup>

I zgjedhur Deputet i Popullit i tërë krahinës së Mokrës, i zgjedhur Anëtar në Këshillin e Lartë Kombëtar nga Kongresin e Lushnjës, personazh i famshëm në shkrimet e Mitrush Kutelit. Në një shkrim “Takimi i Ndonës me Zallorët” ai, xha Ndoni i Çomollarëve, thotë: - Xhaxho, do t’i themi edhe ne, të paktën për atë bijë mjekër që ma kish më se të giatë se sa të priftit të Llëngës- atij të vjetërit, Papa Kostandinit, që shkante në kishë e hynte në meshë me martinë krahut e tapanxhë brezit. Zoti të ruajtë të bije në dyfek të tij, se të grinte! (tregime të zgjedhura faqe 189)

shpatulla thotë se keni lidhje të vjetra me këto anë, mbase nga të parët tuaj. Në shpatull, orakulli i del se juve ju pret një punë e re mbase vitit 2010. Mbase duhet të përgatiteni për t’u bërë parlamentar, që të bësh, jo sa mundesh, por ca më shumë për këtë popull e këtë vend.

Këtu përfundon rrëfimi për ju, ndërsa ç’thotë shpatulla për mua, nuk tregohen, se më humbet fuqia si dhunti në këtë profeci të provuar, besoj dhe në këtë gosti. “Më thertë Shën Marenë mua”, kështu thuhet edhe sot nëse nuk thua të vërtetën dhe vetëm të vërtetën.

Për sa i takon këtij rrethi miqsh, këtu del se vitin tjetër duhet të shtohet kurbanit, duhet të jetë me dy koka. Vendtakimi del se do jetë rrëzë një Mali të Shënjtë. Dollibashit, mikut të parë atje, në atë vend, do t’i vihet plus dhe pjesë mishi nga kurbanit me “nishan”, si e do zakoni. Mishi i kurbanit do jetë rritur nga blegtorë me gjak të ri në deje. Le t’i lutemi Zotit të na japë forcë e shëndet dhe viti 2010 të na gjejë më të ditur e më të pasur e më pjellorë nga mendja se sot.

Pogradec, 28 korrik 2009

Koço Pihoni

# Libra të rinj të Sh.B. "D.I.J.A - Poradeci"

Pavlina Kristo



Roman  
**Era e shekullit**



## Era e shekullit

Pavlina Kristo në romanin e saj të pestë "Era e shekullit" shpalos ashtu si edhe në romanet e mëparshme botën shpirtërore të gruas së thjeshtë në përditshmërinë e saj. Ajo hedh një hap më tej në pasqyrimin e aktualitetit tonë, me ngërthimin e problemeve të mprehta sociale.

Autorja kap në roman motivin e njohur të ndarjes dhe të rikthimit, duke zbërthyer nëpërmjet këtij motivi natyra dhe karaktere njerëzorë në marrëdhëniet sa të thjeshta e të dukshme, aq të ndërlikuara e shpeshherë të pakuptueshme.

Bota e femrës shqiptare shpaloset para lexuesit me të gjithë bukurinë dhe kompleksitetin e vet. Duke e vendosur në situata të

ndryshme, ajo rithekson edhe njëherë rolin në shoqëri dhe në familje, me cilësi e virtyte si dashuria, dhembshuria, toleranca, dëshira për kulturë e dije, por edhe këmbënguljen për të çarë përpara me çdo kusht, si një mënyrë të afirmimit të vetvetes.

Pavlina Kristo ka një gjuhë të thjeshtë pa stërhollime stilistike. Por shpesh proza e saj, veçanërisht në përshkrimin e natyrës, apo në meditime e përsiatje për jetën, merr karakterin e poezisë, duke i dhënë larmi mjeteve të komunikimit me lexuesin. Është për t'u vlerësuar këmbëngulja e autores për të kompletuar nëpërmjet ciklit të romaneve të saj sociale, pasqyrimin e botës sot, në vlerësimin dhe këndvështrimin e njeriut të thjeshtë.

## Dhe dielli lind...

Llaqi Zoto pas botimit të tre librave, u ofron lexuesve një vëllim me një strukturë origjinale, ku përfshihen një cikël me poezi, dy komedi dhe një skenar. Mund të duket disi e panatyrshme, por ai ka arritur t'i bëjë të qëndrojnë pranë njëra-tjetrës gjini të ndryshme letrare. Në këtë vëllim komedia dhe skenari kanë nota të dukshme poetike, kurse poezitë, veç lirizmit përmbajnë edhe drama njerëzore, edhe elementë komikë. Mbi të gjitha këto gjini të ndryshme i bashkon aroma e Devollit që ndjehet dukshëm në çdo rresht. Vëllimin kryesor në aspektin tematik në këtë libër e zë aktualiteti. Diku me lirizëm, diku me nota dramatike ndihet atmosfera e ditëve tona. Bëhet fjalë për braktisjen e fshatit, emigracionin masiv, ligjërime politikanësh, marrëdhëniet e reja të krijuara në shoqëri dhe në familje...

Në poezinë "Trishtimi", mes të tjerash autori thotë: "Përballë me shtëpinë time/ Shtëpi të braktisura./ Pa xhama e dritare./ Brenda banon/

Errësira." Po kjo temë, po ky motiv, por në një trajtë tjetër, haset në komedinë "Stinët e një dite vere": një baba me banim në fshat feston 70-vjetorin. Ka 6 djem e 6 nuse, por të gjithë janë larguar në emigracion, duke e lënë të jetojë vetëm në fshat. Befas të gjithë mbledhen të bëjnë një festë të madhe për përvjetorin e "babushit". Në skenën groteske të krijuar, zbulohet plani i nuseve që ta mbajnë "babushin" të gjitha me radhë në familje, sepse ai ka pension dhe të ardhura të tjera të lakmueshme. Ky ishte dhe shkaku i dashurisë së beftë për të.

Në libër të bën për vete singleriteti i autorit në dhënien e ndjenjave të kundërta, detajeve jetësore dhe përgjithësisht botës së tij poetike e njëherazi dramatike. Ai është besnik i poezisë dhe i temave tradicionale. Por, po aq mirë tenton të trajtojë edhe motivet me nuancë të theksuara moderne. Me sensin e tij realist, krijon një tablo komplekse të jetës së sotme, sa të lodhshme aq dhe stresante...

LLAQI ZOTO

## dhe dielli LIND...

Poezi & Dramaturgj




## Promovim i librit

Më 10 gusht 2009-Strugë, forumi i intelektualëve shqiptarë të Strugës i udhëhequr nga kryetari i saj, Mr.Xhemi Hajredini dhe klubi i shkrimtarëve shqiptarë me kryetar Dr.Nuhi Vinca, në bashkëpunim me departamentin e arsimit dhe kulturës pranë komunës së Strugës, organizuan promovimin e librit me tregime “Harro se ç`kemi biseduar” të autorit Ibrahim Abedini. Tubimi u mbajt në sallën e komunës së Strugës.

Të pranishëm në sallë, përveç gazetarëve, televizionit, miqve të autorit, dashamirëve të artit dhe të kulturës, ishin edhe Dr.Xhevat Gega dhe Dr.Remzi Nesimi, profesorët e dikurshëm të autorit në fjalë. Fjalën e hyrjes e hapi Mr.Xhemi Hajredini. Ai, përshëndeti me fjalë të ngrohta të pranishmit në sallë dhe shprehu një indinjatë dhe keqardhje të thellë për ata shkrimtarë dhe intelektualë që për shkaqe dasdash dhe ahengjesh lënë mënjanë tubime të llojit siç është ky promovim me interes për të gjithë; dhe vijoi më tej të flasë për autorin e librit, për mikun e shokun e tij, për jetën dhe veprimtarinë e tij shumëvjeçare, si vendës i Strugës dhe si autor i pavarur në egzil.

Ibrahim Abedini, theksoi Xhemi Hajredini ndër të tjera, sa herë që vjen nga kurbeti me vete sjell nga një libër që gëzon të gjithë adhuruesit e librit. Kësaj radhe, tha Xhemiu, Ibrahim Abedini në pesëmbëdhjetë tregimet sa përmban libri ka shterur me fanatizëm të gjitha frazeologjitë e gjuhës së qëndrueshme. Fjalët e urta popullore që ne i përdorim në jetën e përditshme, krahasimet e thashethemet e trevës së Strugës janë prezent në të gjitha tregimet që i japin një kolorit të veçantë shprehjeve gjuhësore të tregimeve.

Tregimet e Ibrahimit me personazhet e tyre të qëlluara kanë kaluar nëpër periudha kohore të vështira, në kohën që ishte “një pilaf me gozhdë” që do të thoshte profesor Nesimi, tha ndër të tjera Xhemiu. Dhe theksoi më tej se: - Unë, Xhemiu do thoja se, kur të futje lugën në atë pilaf do të kapje gozhdë në vend të fijeve të pilafit. Xhemiu foli për disa hollësi të tregimit



# “Harro se ç`kemi biseduar”

“Sherri” dhe “Selimi” dhe nuk deshi të flasë për tregimet e tjera meqë i dha fjalën Dr.Nuhi Vincës që njëherit e kishte edhe fjalën kryesore për librin me tregime.

Parathënien e librit, që duhej ta lexonte ose të fliste për të, Kasëm Saliasi, redaktori i vetë librit, i cili nuk qe prezent në këtë ceremoni për shkaqe objektive, në vend të tij e lexoi Mr. Bexhet Hasani.

Më tej fjalën e mori Dr. Nuhi Vinca, i cili, veprën e Ibrahim Abedinit “Harro se ç`kemi biseduar” të botuar në Tiranë- 2009 me 256 faqe e quajti: “një vepër monument, testament e dokument i një kohe”. Të promovosh një libër do të thotë të flasësh për herë të parë publikisht pa e hapur derën e debatit apo të tribunës, (së mendimit pro et contra). Për të qenë më i qartë do të them se në trevën e Strugës me 22 vendbanime shqiptare, nga është edhe autori ynë që e promovojmë, është një ritual shekullor, jo për libra, sepse ato s`i kemi pasur për shkaqe të njohura historike, por për lindjen e foshnjës që organizohet në natën e tretë kur shtrohet sofa dhe rrokulliset foshnja me urime e përgëzime të stilit festiv. Kështu e mendojmë edhe promovimin e librit. I urojmë sukses lindjes së një vepre të quajtur “Harro se ç`kemi biseduar”, me të

pesëmbëdhjetë tregimet dhe një parathënie dhe me 256 faqet e tij me shkronja të imta kompjuterike. Secili tregim i ka mbi 20 deri më 36 faqe. Te secili tregim të kënaq gjuha poetike e të bën krenar qëndresa prometike nëpër valët e kohës e kontekstet historike. Pastaj gjuha poetike, çështjet e ndryshme të jetës bashkëkohore që trajtohen, janë ato që dëshirojmë t`i analizojmë e t`jua themi juve dashamirë të artit e të fjalës, që ju përshëndesim me përzemërsi.

Libri është para nesh. Është një fakt real me të gjitha vlerat, imazhet e mesazhet dhe flet për ata që kanë vesh dhe intuitë. Urdhëroni e më vlerësoni, por para se të thoni diçka për mua si fakt real dhe artistik ju lus të mos më gjykoni pa më lexuar se autori më ka krijuar me shpirt poetik e prometeik. (Aludim te tregimi “Harro se ç`kemi biseduar”)

Pas Dr.Nuhi Vincës, Xhemi Hajredini i dha fjalën autorit të librit, Ibrahim Abedinit, i cili, pasi përshëndeti pjesëmarrësit me fjalë të ngrohta shtoi edhe këto fjalë për librin:

-Ky është libri im i parë me tregime për të rritur. Por në radhitje të veprave është botimi im i shtatë. Kësaj radhe, ndryshe nga radhët e tjera, nga tregimet për fëmijë dhe

nga poezia kalova në tregime për të rritur. E bëra këtë nga dëshira dhe nga nxitja shpirtërore për të shpalosur në letër dhe për t`i bërë të pavdekshme këto tema, sa interesante aq edhe të dhimbshme, sa të ngatërruara aq edhe të kapshme për lexuesin që të jetë sa më afër një realiteti që e ka dëgjuar ose që e ka pas para syve, ose edhe që e sheh kudo në jetën e përditshme; ose edhe vetëm në rrethana të caktuara, por jo në tërësi si në këto tregime.

Kam prekur tema të ndryshme të jetës dhe këtë e kam bërë duke u nisur nga ajo se: - Shkrimtarin nuk e obligon asgjë që të jetë i lidhur pas një teme të vetme (po i lëvize sytë, ato nuk shohin më një drejtim të caktuar). Për lexuesit, adhuruesit e tregimit kam prekur tema që ngjallin interes dhe që bëjnë përshtypje, por jo duke trilluar ngjarje apo ndodhi dmth. gjithmonë duke iu afruar dhe kapur realitetin e jetës. Unë jam munduar që në këto tregime të sjell diçka të re, jo vetëm në kuptimin e temës, por në vetë mënyrën e trajtimit të ngjarjes dhe në aspektin e përdorimit të lirë të fjalës duke mos u frenuar as edhe në shprehje banale për të arritur efektin e dëshiruar.

Këto tregime janë shkruar pothuajse me të njëjtin stil si shumë tregime të autorëve suedezë, finlandezë e danezë që unë i kam lexuar, por gjithmonë duke mos u larguar nga tradita, nga vlerat shoqërore dhe nga rëndësia kombëtare. Unë e pranoj se në disa raste jam treguar i ashpër me gojën e disa personazheve, dhe herë-herë e kam ngritur edhe zërin e revoltës dhe të nervozizmit si një mjet domosdoshmërie për të zbutur shpirtin e tyre nga padrejtësitë. Si çdo shkrimtar i vendit të tij që është marrë me krijimtari letrare qoftë në vend a qoftë edhe jashtë vendit nuk ka lënë anash ose pa përmendur bukuritë e natyrës si: malet, shkrepat, lumejtë, liqejtë me atë gjallërinë dhe origjinalitetin që kanë. Dhe më tutje ua lë lexuesve në dorë të lexojnë e të vlerësojnë tregimet.

Përgatitur për shtyp nga  
**I.Abedini- Göteborg, Suedi**



## “Ringjallet Rilindja e Lasgushit”:

Petro Prifti i rikthehet edhe një herë Lasgushit me këndvështrimin e tij original, si studiues dhe si polemist.

*Vlerësime dhe rivlerësime, fakte të reja, të pathëna më parë; Lasgushi, ashtu siç e ka njohur Petro Prifti.*

**Botimi më i ri i shtëpisë botuese  
“D.I.J.A Poradeci”,  
çmimi 1000 lekë**

Për banorët e Pogradecit ka  
**30 %  
zbritje**

### KONKURS

#### BOTIMET MË TË MIRA!

Gazeta “Nositi” me rastin e 15-vjetorit të daljes së numrit të parë do të shpallë tre botimet më të mira të Entit Botues “D.I.J.A Poradeci” për periudhën janar 2008-maj 2009:

-libër me poezi

-libër në prozë artistike

-libër në gjini të tjera

Jeni të ftuar të jepni votën tuaj duke dërguar titullin e librit më të pëlqyer pranë redaksisë së gazetës “Nositi” brenda datës 30 shtator 2009, ose me email [redaksianositi@yahoo.com](mailto:redaksianositi@yahoo.com)

*Fituesit do të shpallen në tetor 2009, në muajin e Letërsisë dhe të Arteve dhe do të shpërblehen.  
Redaksia*

KONKURS  
POETIK



# KONKURS POETIK

*Të nderuar lexues, bashkëpunëtorë dhe dashamirës!*

**Konkursi Poetik që organizuam me rastin e 15-vjetorit të Nositit më 15 qershor, mori përmasa, të cilat nuk i kishim parashikuar. Në redaksi kanë ardhur dhe vazhdojnë të vijnë cikle me poezi nga autorë shqiptarë, brenda e jashtë vendit, nga Kosova, Belgjika, SHBA, Kanadaja etj.**

*Për t'u lënë mundësi edhe poetëve të tjerë që të marrin pjesë, me sugjerimin e disa miqve të Nositit, vendosëm që konkursin ta lëmë të hapur deri më 30 shtator. Përvjetori i Nositit dhe shpallja e fituesve do të bëhet në tetor 2009, në Muajin e Letërsisë dhe Arteve.*

*Ju falënderojmë për mirëkuptimin!  
Redaksia*

## SHËNDETI

*Merruni sa të mundni me fizkulturë e sport përgjatë gjithë jetës, frekuentoni banjat e diellit, duke shmangur mbipeshën dhe duhanin*

# OSTEOPOROZA

Osteoporozja është një sëmundje e kockave, që shoqërohet me prishjen e strukturës së kockave për shkak të largimit të kalciumit prej tyre. E thënë më thjesht, masa e kockave i ngjan çimentos dhe kalciumi me kripërat e tjera minerale i ngjajnë skeletit prej hekuri, të dyja bashkë formojnë betonarme. Mungesa e kalciumit i bën kockat më të buta e për pasojë më të thyeshme.

Pa të drejtë disa mjekë e quajnë osteoporozën sëmundjen e pleqërisë, por për mendimin tim nuk është krejt kështu, sepse, siç do ta shohim dhe më poshtë, vërtet që ekspozimi i kësaj sëmundjeje bëhet në moshë madhore, por fillesa e saj është qysh në moshën aktive. Pra osteoporozja është një sëmundje që shfaqet qysh në moshën 45-55 vjeç tek femrat dhe mbi moshën 60 vjeç tek burrat, me një prevalencë prej 80 për qind më shumë tek femrat. Kjo është e lidhur me ndryshimet hormonale që ndodhin në trupin e femrës gjatë dhe pas menopauzës. Por kjo përqindje barazohet pas moshës 65-70 vjeç.

Po cilat janë shenjat e kësaj sëmundjeje, me qëllim që ju të dini t'i evidentoni, t'i specifikoni, për t'u drejtuar më pas tek mjeku i familjes, i cili do të bëjë vlerësimi, konfirmimin dhe trajtimin tuaj?

Shenja më e shpeshtë e osteoporozës është dhimbja përgjatë kockave (jo në artikulationet). Karakteristike është dhimbja e shtyllës kurrizore e vazhdueshme, madje edhe në qetësi, shtrirë në krevat. Këto dhimbje të thella, të mbytura, nuk acarohen dhe as qetësohen me anë të lëvizjeve. Tjetër shenjë mund të jetë deformimi i shtyllës kurrizore apo shkurtimi i gjatësisë së



shtyllës kurrizore, apo shkurtimi i gjatësisë së trupit.

Por në shumicën e rasteve osteoporozja mbetet e fshehtë deri në momentin e një frakture shpesh pa ndonjë shkak të dukshëm. Më të shpeshta janë frakturat e trupit të vertebrave, coksofemorale dhe të pjesëve të poshtme të kockave të gjata. Duhet të nënvizoj këtu se një frakturë serioze në një moshë madhore në 20 për qind të rasteve bëhet fatale edhe për shkak të fenomeneve të tjera që ndodhin në trupin e të moshuarit gjatë qëndrimit të detyruar shtrirë për një kohë të gjatë.

Cilët janë faktorët predispozues të kësaj sëmundjeje? Siç e theksova edhe më lart, osteoporozja fillon qysh në moshën aktive, madje në

disa raste qysh në rini. Shkaku kryesor është mungesa e kalciumit në organizëm. Kjo shkakton zbutjen e kockave dhe për pasojë i bën ato më të thyeshme. Mungesa e kalciumit në organizëm për pasojë edhe në kocka, përgjithësisht vjen nga mosplotësimi i nevojave me anë të ushqimit. Një rol negativ ka jeta sedentare pa fizkulturë e sport, pasuar dhe me mbipeshën.

Mosfrekuentimi i banjove të diellit është një tjetër faktor negativ. Menopauza është një fenomen tjetër që e evidenton ose e përshpejton osteoporozën. Për moshat e thyera një rol negativ luan ulja e shijes dhe e nuhatjes, pasuar këto me uljen e oreksit që sjellin uljen në sasi dhe cilësi të ushqyerjes (kequshqyerje).

Nga ana tjetër ulja e forcës thithëse të ushqimit në aparatit tretës, patjetër që do të ishte një faktor rëndues. Nga studime të shumta është vënë re një lidhje e fortë e osteoporozës me barrat e tepërta dhe me personat që pinë duhan. Së fundi dua të përmend se ka disa sëmundje të tjera me ndikim indirekt, ku pacienti është i detyruar të marrë kortizon për një kohë të gjatë.

Si mund t'i paraprijmë kësaj sëmundjeje? Duke iu referuar gjithë sa përmenda më lart, do t'ju rekomandoja: dhënien e rregullt të vitaminës D ose A+D fëmijëve deri në moshën trevjeçare, dhënien e multivitaminave dhe fluorit të gjitha grave shtatzëna. Konsumoni sa të jetë e mundur ushqimet me përmbajtje të lartë të kalciumit si bulmetrat (qumësht, djathë të bardhë, kos, gjizë të freskët dhe zarzavate e mish viçi. Merruni sa të mundni me fizkulturë e sport përgjatë gjithë jetës, frekuentoni banjat e diellit, duke shmangur mbipeshën dhe duhanin.

Konsultohuni si mund të shmangni barat e tepërta dhe ato të padëshiruara. Së fundi, nëse vëreni shenja sado të lehta, konsultohuni me mjekun e familjes, i cili është kompetenti për saktësimin e diagnozës. Diagnoza është fare e lehtë. Përveç anës klinike që përshkrova më lart, mund të kërkohet një grafi e thjeshtë dhe/ose matja e densitetit të kalciumit në kocka.

Përa i përket mjekimit parandalues, kemi dhënien e preparateve të thjeshtë të kalciumit dhe me vitaminë D, personave në risk. Kurse për mjekimin e sëmundjes do të shfrytëzohen preparate më moderne, por edhe më të kushtueshme si grupit të kalciumeve ashty dhe të grupit të bifosfateve.

**Dr. Andrea Kocaqi**

*Mjek familjeje, ambulanca Libonik, Korçë*

# Horoskopi javor i "Nositit"



## Dashi (21.3-20.4)

Mendohuni mirë para se të flisni, ndryshe do të kaloni javën duke sqaruar keqkuptimet që do të krijoni.

## Demi (21.4-20.5)



Emocionet tuaja do të jenë deri diku shpërthyes. Nuk do të jeni në gjendje të frenoni veten.

## Binjakët (21.5-21.6)



Javë e përshtatshme për të reflektuar mbi gjërat që doni të kryeni. Merreni gjithçka me qetësi.

## Gaforrja (22.6-22.7)



Mund të ndrydhni ndjenjat tuaja nga frika e reagimit të të tjerëve. Lini mënjane guackën ku jeni futur.

## Luani (23.7-23.8)




Mos i lini pas dore ëndërrat tuaja, pasi do t'ju ndihmojnë për perspektivën e asaj që do të kryeni.

## Virgjëresha (24.8-23.9)



Megjithëse mendoni se do të jeni perfektë, mos harroni se mund të zhgënjeheni. Më shumë imagjinatë.



## Peshorja (24.9-22.10)

Këtë javë duhet të përqëndrohemi në aktivitete krijuese. Do të takoni njerëz që ju pëlqejnë.

## Akrepi (23.10-22.11)



Javë mjaft e lodhshme, do të jeni shumë të ngarkuar me punë dhe si rezultat i presionit të eprorëve.

## Shigjetari (23.11-22.12)



E shkuara dhe e ardhmja do të përplasen dhe nuk do të kuptoni se cila është e tashmja juaj.

## Bricjapi (23.12-20.1)



Gjërat që i keni konsideruar të qëndrueshme, mund të pësojnë plasaritje. Nuk do të keni siguri.

## Ujori (21.1-19.2)



Do të akuzoni vetëm në mendjen tuaj njerëzit që ju rrethojnë. Do të kontrolloni me vëshirësi veten.

## Peshqit (20.2-20.03)



Javë e mbushur me aventura dhe aktivitete. Do të ndiheni të rilindur pas periudhës stresuese.



-Ishe tek Dasma e Figaros?

-Nuk kisha kohë, por i dërgova një telegram.

\*\*\*

Viktimën e një aksidenti të qarkullimit e sjellin në spital. Doktorin e ekzaminon dhe thotë:

-Lavdi Zotit, vetëm një plagë është vdekjeprurëse, të tjerat mund të shërohen.

\*\*\*

Në një dyqan shitësi pyet një djalë të vogël:

-Për cilin ble kaq shumë paketa cigare? Për babain?

-Jo. Për gjithë klasën!

\*\*\*

Pas një pritje të gjatë, shfaqet dhe kamrieri.

-Shiko zotëri çfarë ndodhi për fajin tuaj! Duke prit burri im hëngri gazetën.

-Ska gjë zonzë. Ishte e djeshmja!

\*\*\*

John takon në rrugë një mikun e tij të vjetër.

-Më thuaj ke mbetur deri tani katër herë i ve dhe martohesh përsëri me një motër të grave të tua. Kaq simpatike të duket kjo familje?

-Simpatike? Çfarë thua! Dua t'i jap fund këtij klani të mallkuar.



# Vipat Top Sekret

## Receta e Michelle Obamës për formën perfekte

SHBA- Fitnes për zemrën, ngritje te vogla peshash, ushtrime specifike për të mbajtur trupin në formë. Dhe më pas, sigurisht një dietë të pasur me perime dhe



fruta, jo shumë kalori dhe jo shumë të ëmbla. Është kjo receta për të qenë në formë sipas Michelle Obamës, e cila ka thënë gjithçka gjatë një interviste në një reviste për femrat në SHBA.

Në ndryshim nga gratë e para që kanë qenë në Shtëpinë e Bardhë, Michelle me kënaqësi ka dalë duke nxjerrë krahët jashtë, ku sipas një informacioni online janë pikërisht krahët zona më kryesore e stërvitjes së gruas së parë për të qenë në formë. "Jam me të vërtetë e bindur në fuqinë dhe forcën fizike dhe shëndetësore", ka thënë Michelle në lidhje me shëndetin e zemrës dhe atë të peshës.

### Shembull edhe për fëmijët

"Një cilësi e mirë shëndetësore është mjaft e domosdoshme gjatë stërvitjeve të ndryshme, për t'u bërë pjesë e jetës sonë, por edhe për fëmijët tanë", ka shpjeguar Michelle gjatë intervistës së saj. "Ne jemi pikërisht modeli i tyre dhe nëse ata na shohin se ne jemi duke bërë gjimnastikë dhe reflektojnë në atë që hanë dhe shohin prindërit e tyre, duke parë si punon, duke bërë gjimnastikë dhe sport, kur të rriten do t'i konsiderojnë të gjitha këto si pjesë të pandashme e të qenit të ri".



## Angelina Jolie me e fortë se Brad

Jolie në vendin e parë në renditje në sfilatën e Forbes e ndërsa Pitt...

LOS ANGELOS (SHBA) - Angelina Jolie është më e fortë se



Brad Pitt. Aktorja është në majë të klasifikimit nga Forbes në 100 të famshmit e më të fuqishëm. Angelina ka rrëzuar dhe prezantuesen e njohur televizive në SHBA, Oprah Winfrey që këtë vit i është dashur të kënaqej me vendin e dytë.

Me 27 milion dollarë të fituara në 12 muajt e fundit, Angelina nuk ka pasur rivalë, duke tejkaluar dhe Bradin e saj, e megjithatë, ai doli në vendin e nëntë. Përveç se Jolie është e pasur, e famshme, ka talent, e bukur dhe jeta e saj private bashkë me gjashtë fëmijët në veçanti, e bëjnë një njeri të famshëm e të ndjekur nga audiencia në mbarë botën. Pitt i duhet të kënaqet me të tjerat ...

**Zgjedhja e sigurtë  
kërkon një bankë të sigurtë.**

**Depozita**  
me interes fiks  
deri në\*

**9% Lekë**  
**6,25% Euro**

\*Norma e interesit është në varësi të afatit dhe shumës.

www.bpopullore.com

**BANKA POPULLORE**  
SOCIETE GENERALE GROUP

Së bashku për të ardhmen

**Horizontalisht:** 1.Franc... ka qenë futbollist i shquar gjerman 8.Inicialet e shkrimtarit Gorki 11.Letër bixhozi 12.Agron..., humorist 13.Emër tipik gjerman 14.Komedia "...në plazh" 16.Kryeqyteti i Perusë 18.Eshtë agrume 21.Taka pa ta 22.Inicialet e Nevskit 23.Targa e një qyteti bregdetar 24.Emri i trajnerit gjerman të kombëtares greke të futbollit që e nxori kampione Evrope 25.Përemër vektor 26.Emri i ish aktorit Frashëri 28.Targa e një qyteti jugor 30. ...Montan 31.Diftongu në ralisht 32.Inicialet e futbollistit Tare 33.Lumë në Gjermani 34.Inicialet e ish kancelarit gjerman Kohl 37.Një paraardhës i hotelit 38.Inicialet e Dymas 40.Njeriu i xhunglës 43.Lakuriq 45.Ishte ushtria e Gerri Adams në Irlandën e Veriut 46.Si nr.37 47.Lumë në Brazil 50.Dymijë e një romake 52.Argjendi për kimistët 54.Lloj vaji ushqimor 55.Çiço i ekranit 57.Kryeqyteti me Koloseun 59.Inicialet e Konicës 60. ... i Këngëve dhe Valleve Popullore 61.Ai dhe ajo 62.Aktori Paçino

**Vertikalisht:** 1.Kryeqyteti i Rumanisë 2.Malet... në Rumani 3.Ka kryeqytet Talinin 4.Qytet në SHBA 5.odiesea në Itali 6.Elbasani në makina 7.Futbollisti spanjoll Gonzales 8.Ka kryeqytet Bamako 9.Xhedi 10.Qytet në Kosovë 15.Simbolet kimike të hidrogjenit dhe oksigjenit 17.Lumë në vendin tonë 19.Shtet kaukazian 20.Kryeqyteti i Portugalisë 27.Kryeqyteti me Akropolin 29.Simboli kimik i një metali radioaktiv 35.Opera e Zhorzh Bizësë 36.Sebastian..., kompozitor i njohur 38.Emri i Hitlerit 39.Gruaja e Skënderbeut 41.Emri i ish këngëtarit të operas Kovaçi 42.Simboli kimik i metalit të kripës së gjellës 44.Lloj pije alkoolike 48.Prokop..., ka qenë aktor 49.Inicialet e Moisiut 51.Patrioti Boletini 53.Lloj ngjyre 55.Perëndia egjiptiane e diellit 56.Inicialet e ukrainasit të kërcimit me shkop Bubka 58.Këngëtarja Take, inicialet

1		2	3		4		5	6	7		8	9		10
		11					12							
13					14	15					16		17	
		18						19		20			21	
		22					23					24		
		25			26	27				28	29		30	
		31			32			33						
34	35			36		37						38	39	
40		41			42					43	44			
45				46				47	48					49
	50		51			52	53				54			
55					56	57				58		59		
60										61				62

**Përgjigjet e fjalëkryqit të numrit të kaluar (Nr. 465)**

**Horizontalisht:** 1.Rabitanat 7.Anton 11.Pro 12.Havana 14.Librarët 16.Ze 18.Bene 19.Mi 20.Trim 23.Shefi 25.Kau 26.SHISH 27.Nasho 28.Mal 30.Iva 32.Na 34.Obi 36.Ra 37.Kolombo 39.Ne 40.Rita 42.KU 43.SK 45.VL 46.Atalanta 48.Bono 49.In 50.Oslo 51.LU 53.Ima 56.Akra 57.Iliada 58.Di

**Vertikalisht:** 1.RPK 2.Ar 3.Boletini 4.Tebeshiri 5.Njamena 6.Themistokli 7.AV 8.Narta 9.TN 10.Oazi 13.Ati 15.In 17.Emil 21.Rum 22.Aston Vila 24.Fa 25.Kono 29.Atos 31.Vatani 33.Amato 35.Bel 38.Luan 40.Rubla 41.Atomi 44.Kromi 47.Asi 52.Uk 54.AI 55.LD

**Botues: Ilir DUKA & Afroviti GUSHO**  
**Në kompjuter: Edlir PODA**  
**Lexoni gazetën në: www.poradeci.com**  
**Gazeta shpërndahet në Qarkun Korçë**

**Enti Botues: "D.I.J.A. Poradeci", -Pogradec**  
**Adresa e Redaksisë: Rruga "Rinia", Pallatet 7-katësh, Pogradec**  
**Tel: +355 832 2905, Mobil: 069 2143753**  
**e-mail: afrovitig@yahoo.com;**  
**redaksianositi@yahoo.com**